

Lëshimi i deklaratave

Përshkrimi

Lëshimi i deklaratave të ndryshme para konsullit.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Një dokument identifikimi si pasaportë ose kartë identiteti biometrike;
- 2) Kopje e tekstit të deklaratës noteriale konsullore, nënshkruar nga i interesuari;
- 3) Dokumente mbështetëse, nëse do të kërkohen, që konfirmojnë rregullshmërinë ligjore të deklaratës së kërkuar;

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personalisht e personit të interesuar para konsullit ku bëhet verifikimi i identitetit të tij;
- 2) Dorëzimi i mandat-pagesës origjinale të tarifës, që ka derdhur në numrin e llogarisë së përfaqësisë diplomatike ose konsullore të RSH;
- 3) Kontrolli nga konsulli i rregullshmërisë ligjore të përmbajtjes së deklaratës;
- 4) Lëshimi i deklaratës;
- 5) Një kopje e dokumentit, pasi është vërtetuar autenticiteti i tij dhe i është vendosur pulla taksë, mbahet në arkivin e ambasadës apo konsullatës.

Tarifa e shërbimit dhe afati

20 euro ose tarifa ekuivalente në monedhën vendase.

Lëshimi bëhet në momentin që paraqitet i interesuari.

Zyra

Të gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Në rastet kur konsulli nuk është i bindur për rregullshmërinë ligjore të deklaratës së kërkuar, kryhet verifikimi i të dhënave të përmbajtjes së saj përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme ose Institucionit të vendit që e ka lëshuar atë

Në vendet që nuk ka Ambasadë apo Konsullatë shqiptare, të interesuarit i drejtohen noterëve vendas. Për t'u njohur nga autoritetet në Shqipëri vërtetimet e noterëve vendas duhet të legalizohen ose apostilohen, si çdo dokument tjetër i huaj.